



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Nr. 19, datë 28.10.2021

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Tetor, që zhvillohet tek
salla e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00

Data e mbajtjes së mbledhjes : 28.10.2021

Mbajtja e mbledhjes : salla e Qendrës Kulturore “ Aleksandër Moisiu”

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Rradhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës : Znj.Emiriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit Bashkisë dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Ani Dyrmishi : Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare !

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për muajin tetor të Këshillit Bashkiak Durrës.

Së bashku me Kryesinë e Këshillit kemi vendosur, që kjo mbledhje plenare të mbahej e drejtpërdrejt në Qendrën Kulturore Aleksandër Moisiu, duke patur mundësinë që të ruanim distancat sipas udhëzimeve të Ministrisë së Shëndetësisë.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë mbi projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë si dhe informohemi mbi sezonin turistik në Durrës për këtë vit. Materialet Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretarja Këshillit, besoj jeni të gjithë të njohur.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj prezencën e këshilltarëve.

Dorina Milja: Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën. Jolanda Mustafaraj ... prezent.....etj..... Morena Boja.....prezent.

Kryetar ke 43 këshilltarë në sallë.

Ani Dyrmishi : Meqë kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me mbledhjen.....

Pikat, që shtrihen sot për shqyrtim, miratim dhe informim janë 19 pika, ku 4 pikat e fundit janë shtesë.

Po prezantoj pikat një e nga një si më poshtë:

1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN TETOR 2021
2. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR.32, DATË 26.03.2021, PËRSA I PËRKET LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR 4 BANESA KOLEKTIVE, LAGJA NR.17, RRUGA “LURA”, DURRËS TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
3. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB 104, DATË 31.08.2021 “PËR NJË SHTESË NË VKB NR.127, DATË 24.12.2020 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E DURRËSIT PËR VITIN 2021” NË LIDHJE ME MIRATIMIN E TARIFËS SË UJIT PËR UJITJE
4. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 7.816.200 LEKË AKORDUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR BASHKINË DURRËS, PËR SUBVENCIONIMIN E QIRASË PËR FAMILJET, QË PËRMBUSHIN KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BONUSIT TË STREHIMIT
5. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR BASHKINË DURRËS
6. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 1.524.086 LEKË AKORDUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË PËR GRANTIN E MENJËHERSHËM, PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË ULJE TË VLERËS SË KONTRATËS
7. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 286, DATË 13.08.2002 “STREHIMIN E FAMILJEVE NË APARTAMENTET E BANIMIT TË MAGAZINAVE TË DUHAN CIGARES NË ZONËN E RRASHBULLIT DURRËS SIPAS LISTËS SË MIRATUAR ME VKM-NË NR.34, DATË 20.01.2001, PËRSA I PËRKET LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE TË STREHURARA NË APARTAMENTET E BANIMIT TË MAGAZINAVE TË DUHAN CIGARES NË ZONËN E RRASHBULLIT DURRËS
8 Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË VKB NR. 74, DATË 24.07.2020, VKB NR. 77, DATË 10.08.2020, VKB NR. 86, DATË 31.08.2020, VKB NR. 104, DATË 31.10.2020, PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT PËR RIKONSTRUKSIONIN OSE RIPARIMIN E BANESAVE TË DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË

	SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT TË SHKAKTUAR
9 Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË PROGRAMIT TË KREDISË SË LEHTËSUAR PËR STREHIM ME 3 % INTERES
10 Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHITESË NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 05.03.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
11 Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 77, DATË 28.06.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 3, 5, 7, RRUGA “BASHKIMI” , PALLATI NR.1, RRUGA “DEMOKRACIA”, PALLATI NR.2/1, RRUGA “PROGRESIT”, PALLATI NR.6, RRUGA” MILENIUMI” DHE PALLATI NR.4, RRUGA”MINIERËS” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE MANËZ, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
12 Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE RREGULLAVE PËR FALJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE ME KARAKTER NDËSHKUES TË VENDOSURA NGA BASHKIA DURRËS, NË PERIUdhËN 23 SHTATOR – TËTOR 2020, NDAJ FAMILJEVE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSITË NATYRORE, TËRMETET E DATËS 21 SHTATOR DHE 26 NËNTOR 2019
13 Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË ANEKSIN 2, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE PËRFITUES QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR.14, RRUGA “PETRAQ BOSHNIJAKU”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”
14 Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË QENDRËS SË RE SHËNDETËSORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ISHËM, BASHKIA DURRËS, “DR. XHAFERR MUHARREMI”
15 Informacion Këshilltarëve	RAPORTIM PËR SEZONIN TURISTIK NË DURRËS PËR VITIN 2021

PIKAT SHITESË

Pika 16. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT DHE DETAJIMIT TË FONDIT PREJ 561.411.457 LEKË PA TVSH NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 613, DATË 20.10.2021 “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË DURRËS”
Pika 17. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PROÇEDURAT E ZHVILLIMIT TË SHORTEUT PUBLIK MANUAL NË BASHKINË DURRËS NË KUADËR TË RINDËRTIMIT
Pika 18. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 4, 6, MANËZ DHE SUKTH, BASHKIA DURRËS, TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
Pika 19. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR PËR KOMPLEKSIN TURISTIK REZIDENCIAL DHE HOTELIER LURA – 5, PËR SHOQËRINË LURA SHPK

Ani Dyrmishi : Në lidhje me rendin e ditës nëse këshilltarët kanë ndonjë koment?

Atëherë nuk ka komente, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet rendi ditës.

- Atëherë kalojmë në shqyrtimin e **projektvendimit nr. 1 të R.D** , i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, z.Petrit Ismailati.

Petrit Ismailati: Përsëritet të gjithëve! Përsa i përket fondit 6 % për ndihmë ekonomike Komisioni Barazisë Gjinore u mblodh dhe dakort për miratimin e saj në Këshill Bashkiak. Faleminderit !

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 1 nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet pika 1 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 2 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Përsëritet të gjithëve! Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike u mblodh për shqyrtimin dhe miratimin e pikës 2 të R.D të ditës sotme dhe në përfundim me shumicë votash propozon kalimin e saj. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Përshëndetje! Gjithashtu dhe Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për pikën 2, propozon me shumicë votash për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 2 nga ana e këshilltarëve kemi ? Po Flutura.

Flutura Kasa : Në mbledhjen e komisionit kam apstenuar për pikën 2, sepse Komisioni i Ankesave duhet të dali me një vendim, jo të sjell që ta gjykojmë “Ne”. Ne miratojmë ato që merr vendim komisioni.

Ani Dyrmishi : Ok, faleminderit. Atëherë koment tjetër kemi ? Jo, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 2, siç ka ardhur nga Komisioni? Kundra ?.... Apstenim ? Nuk ka.
Atëherë me 2 vota apstenim dhe gjithë të tjerat pro miratohet dhe pika 2 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 3 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave, znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave – Tarifave, vendosi pro shtesave dhe ndryshimeve në VKB-në nr. 104, datë 31.08.2021, në lidhje me miratimin e tarifës së ujit për ujitje. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Etleva Velçani.

Etleva Velçani : Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e dërguar me email nga Sekretarja e Këshillit është dakort për kalimin në votim të pikës 3. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 3 nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 3 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 4 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Edhe për këtë pikë komisioni ynë vendosi pro miratimit të saj dhe kalimin për votim nga Këshilli Bashkiak. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit! Edhe për pikën 4 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë dhe propozon miratimin e saj.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përse i përket pikës 4 nga ana e këshilltarëve ka ? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime pika 4 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 5 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike “Për miratimin e planit të integritetit për Bashkinë Durrës”, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përse i përket kësaj pike ka ? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime dhe pika 5 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 6 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave, znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Komisioni ynë vendosi pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Edhe për pikën 6 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përse i përket pikës 6 të R.D, ka nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 6 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime dhe pika 6 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 7 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Edhe për pikën 7 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përse i përket pikës 7 të R.D kemi nga ana e këshilltarëve? Nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 7 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Miratohet me vota unanime dhe pika 7 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 8 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit. Edhe për pikën 8 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni ynë propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 8 të rendit të ditës. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 8 të R.D nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Apstenim Flutura?... ah ok. Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime dhe pika 8 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 9 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z.Elio Jani.

Elio Jani : Faleminderit. Edhe për pikën 9 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 9 të R.D nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime dhe pika 9 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 10 të rendit të ditës** fjalën e ka Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Edhe për pikën 10 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Në mënyrë unanime propozojmë kalimin e pikës 10 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente nga këshilltarët përsa i përket pikës 10 të R.D kemi? Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet dhe pika 10 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 11 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit. Edhe për pikën 11 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Gjithashtu në mënyrë unanime kalojmë pikën 11 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Komete përsa i përket pikës 11 të R.D, ka? Atëherë nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 11 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.
Miratohet me vota unanime dhe pika 11 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 12 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike, për përcaktimin e mënyrës dhe rregullave për faljen e masave administrative me karakter ndëshkues të vendosura nga Bashkia Durrës, në periudhën 23 shtator –tetor 2020, ndaj familjeve të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 12 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Komete përsa i përket pikës 12 të R.D, nga ana e këshilltarëve kemi? Nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 12 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet dhe pika 12 me vota unanime.

- Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit të **pikës 13 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit. Edhe për pikën 13 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 13 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komete përsa i përket pikës 13 të R.D, ka nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 13 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime dhe pika 13 e rendit ditës.

- **Pika 14 e rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Jolanda Mustafaraj.

Jolanda Mustafaraj: Përhëndetje të gjithëve! Dhe Komisioni Arsimit, Rinisë dhe Kulturës është dakort me pikën 14 “Për miratimin e emërimit të qendrës së re shëndetësore në Njësinë Administrative Ishëm”.

Ani Dyrmishi : Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë z. Afrim Bakaj.

Afrim Bakaj: Edhe Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë ra dakort me shumicë votash që t'i vendoset emri “DR. XHAFERR MUHARREMI” qendrës shëndetësore Ishëm. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përse i përket pikës 14 të R.D, kemi nga ana e këshilltarëve? Nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 14 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ?

Atëherë me 1 apstenim dhe të gjitha votat pro miratohet dhe pika 14 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin **e pikës 15 të rendit të ditës**, e cila është vendosur për tu marrë në shqyrtim sipas programit vjetor të punës së Këshillit Bashkiak. I japim fjalën për një raportim për sezonin turistik në Durrës për vitin 2021 znj.Floreta Kërtusha.

Floreta Kërtusha : Përshëndetje ! E nderuar znj.Kryetare Emiriana Sako. Të nderuar Këshilltarë të Këshillit Bashkiak ! Sot kam nderin si përfaqësuese e Drejtorisë së Turizmit, e cila është një strukturë e re e ngritur rishatzi pranë Bashkisë, për të bërë një raportim shkurtimisht në pikat më kryesore që janë të rëndësishme të evidentohen këtu në këtë mbledhje.....etj
Lexohet raporti prej 15 faqesh që i është vënë në dispozicion nga Kryetarja e Bashkisë Këshillit Bashkiak me shkresë nr. 11088/1 prot, datë 22.10.2021.
Faleminderit. Shpresoj të kem qenë e qartë.

Ani Dyrmishi : Faleminderit dhe Ju për informacionin e dhënë. Para se të pyes nëse ka ndonjë koment ose ndonjë pyetje. Ka kërkuar fjalën Kryetarja.

Emiriana Sako : Faleminderit Floreta për informacionin shterues dhe për pamjen 360⁰ për punën që kemi bërë këtë vit në Bashkinë e Durrësit. Desha të theksoja që duke marrë shkas nga sfidat që kemi pasur këtë sezon turistik kemi filluar organizimin e punës që tani në terren me stafin në mënyrë që të adresojmë dhe të zgjidhim problematika përpara se ato të shfaqen në sezonin turistik.

E para, këtë numrin prej 3900 dhomash, që kemi në qytetin e Durrësit kemi ngritur një grup pune nëpërmjet drejtorive të Bashkisë si dhe Njërive Administrative për t'i verifikuar, gjithashtu për t'i azhurnuar në një sistem Gis, në mënyrë të tillë që përveç se databasës të kemi dhe mundësi të aksesojmë më shpejt me shërbimet tona duke i vendosur në kohë reale atje ku ndodhen sipas numrit të dhomave në këtë program.

Nga ana tjetër kemi kërkuar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që procesi për ndarjen e plazheve dhe lidhjen e kontratave të filloj brënda këtij viti në mënyrë që “Ne” në sezonin turistik mos të gjendemi përpara faktit që plazhet janë caktuar, por për çështje dokumentacioni nuk është arritur në kohë realizimi i kontratave. Kështu që, besoj që nga mesi i muajit Nëntor do të fillojmë organizimin e punës për aplikime për plazhe në mënyrë që muaji Mars i vitit tjetër t'i gjej gjitha kontratat e lidhura.

Nga ana tjetër një sfidë të madhe kemi pasur dhe menaxhimin e mbetjeve urbane, pasi tarifat janë pothuajse të unifikuara të pandara me bizneset dhe po shohim po marrim masat meqenëse jemi dhe në prag të miratimit të buxhetit dhe të miratimit të paketës fiskale, po marrim masa që të vendosim zëra specifik në bazë të konsumimit dhe në bazë të nevojave më të larta. Pra, hotelet të cilat kanë një konsum më të lartë nuk do të trajtohen njësoj me bizneset e tjera të vogla apo hotelet e vogla, të cilat kanë një konsum më të vogël, në mënyrë që bashkia të jetë në gjëndje që t'i përgjigjet evadimit të mbetjeve në kohë dhe mos kemi situata të pakëndshme as për qytetarët as për turistët. Ju faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare! Atëherë përsa i përket informimit që bëri znj.Kërtusha dhe Kryetarja kemi ndonjë pyetje ose koment? Po znj.Hatellari.

Adriana Hatellari : Falenderoj zonjën e administratës për këtë panoramë të bukur që na bëri për situatën turistike. Në fakt është e dukshme dhe e prekshme nga “Ne” qytetarët e Durrësit që pas shumë vitesh ka filluar të bëhet, të aktivizohet plazhi brënda qytetit, kështu që puna e bashkisë duket.

Unë doja t’i bëja një pyetje nëqoftëse mundet të më ndihmojë të më japi një përgjigje zonja. Nga 815 parcela plazhi më duket se ishin të ardhurat afër 70 milion, nëqoftëse nuk gabohem. Dua të di sa është kjo, sa janë këto të ardhura krahasuar me vitin 2019, jo 2020. Për mua 2020 nuk duhet krahasuar me asnjë gjë. Këto të ardhura që janë sivjet 70 milion sa janë krahasuar me vitin 2019?

Emiriana Sako : Ta jap unë këtë përgjigje. Ok Floreta, se e kam unë si informacion.

Floreta Kërtusha : Faleminderit ! Jo nuk e kam këtë informacion, duke qënë se është një informacion i mbledhur nga një Drejtori tjetër që është përgjegjëse.

Emiriana Sako : Kryesisht lidhet me ndryshimin e ligjit kjo. Normalisht 2020 ka qënë një vit i dobët përsa i takon turizmit, sepse dihen arsyet. Pavarësisht Durrësi ka pasur kërkesë dhe ka pasur dhe oferta turistike. Në raport me 2019, taksa që “Ne” kemi vjel nga plazhet ka qënë tek 40 milion, ndërsa këtë vit siç e tha dhe Floreta kemi një buxhet akoma më të mirë të cilin mendojmë që ta çojmë në destinacionin e mirëmbajtjes së këtyre zonave, pra ta çojmë në funksion të turizmit. Qoftë nëpërmjet dedikimit në zërin e buxhetit për menazhimin e mbetjeve, qoftë pastaj në investime, që do të jenë të nevojshme për infrastrukturën, e cila orienton dhe ndihmon turizmin.

Ani Dyrmishi : Faleminderit! Atëherë ndonjë pyetje apo koment tjetër përsa i përket kësaj pike? Nuk ka .

- Atëherë kalojmë **në shqyrtimin e pikës 16**, i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave, znj.Pamela Bardhaj.

Pamela Bardhaj: Faleminderit ! Komisioni ynë vendosi me të gjitha votat pro miratimit të kësaj pike. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit. Edhe Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Përsa i përket kësaj pike kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 16 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë me vota unanime miratohet pika 16 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 17 të rendit të ditës** e merr fjalën Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit. Edhe për pikën 17 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores, në lidhje me miratimin e rregullores për procedurat e zhvillimit të shorteut publik manual në Bashkinë Durrës, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 17 të rendit të ditës.

Ani Dyrmishi : Komete përsa i përket pikës 17 të R.D, kemi nga ana e këshilltarëve? Nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 17 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime dhe pika 17 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 18 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

Elio Jani : Faleminderit. Edhe për pikën 18 Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e Bashkisë. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores, në mënyrë unanime propozon kalimin e pikës 18.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komete përsa i përket pikës 18 të R.D nga ana e këshilltarëve kemi?.. Nuk kemi, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 18 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Atëherë miratohet me vota unanime dhe pika 18 e rendit ditës.

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 19 të rendit të ditës** , Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

Etleva Velçani: Po, përshëndetje dhe njëherë! Komisioni i Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi relacionin dhe pas disa diskutimeve me 6 vota pro dhe 1 kundër e kaloi për votim në ditën e sotme. Faleminderit.

Ani Dyrmishi : Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

Alneida Roshi : Komisioni Rregullores, për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar për kompleksin turistik Lura, propozon me shumicë votash kalimin e pikës 19.

Ani Dyrmishi : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 19 kemi nga ana e këshilltarëve?.. Nuk ka, atëherë kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 19 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? Nuk ka.

Kundra 1, të tjerat pro, atëherë miratohet dhe pika 19 e rendit ditës.

- Kalojmë **në pyetjet që kërkojnë këshilltarët** të bëjnë. Merr fjalën këshilltarja Silvana Kavaja.

Silvana Kavaja : Përshëndetje ! Kisha një pyetje për znj.Kryetare. Janë të interesuar banorët e pallatit të oficerave në krah të shkollës Hajdar Dushi, lagja nr.10. Të gjithë banorët e kanë marrë kompensimin nuk ka asnjë lloj problemi dhe merimetimet, rregullimet e banesës i kanë bërë. Por është, faqa, fasada nga jashtë i pallatit është goxha i dëmtuar nga jashtë dhe shkallët e brëndshme. Është komunikuar disa herë me bashkinë dhe banorët normalisht ngaqë po vjen dhe sezoni i dimrit janë të interesuar, sepse po bien dhe tullat.

Emiriana Sako : Ky objekt ka një kategori dëmi...

Silvana Kavaja : DS2-sh.

Emiriana Sako : Po, por me ekspertizë. Pra në bazë të rekomandimeve të ekspertizës “Ne” kemi përfunduar projektin e detajuar, i cili është në Ministrinë e Shtetit për Rindërtimin për miratimin e fondit. Me miratimin e fondit do të vijojmë me procedurat përkatëse për fillimin e punimeve.

Silvana Kavaja : Ok. Faleminderit.

Ani Dyrmishi: Atëherë, tjetër këshilltarë nuk e ka kërkuar fjalën. Nëse Kryetarja do të shtoj diçka. Keni për të shtuar diçka?

Emiriana Sako : Mendova se kishte pyetje tjetër.

Ani Dyrmishi: Jo, jo.

Emiriana Sako : Atëherë sot dua t’Ju falenderoj se me miratimin Tuaj, “Ne” kemi mundur që të miratojmë dhe një program tjetër, i cili është ai i kredisë së butë. Miratimi që kemi bërë sot prek 345 familje, që janë pjesë e këtij përfitimi dhe do të vijojnë procedurat përkatëse me bankat në mënyrë që të kenë mundësinë të sigurojnë një banesë për familjen e tyre. Kryesisht në vlerësimin tonë kemi patur në konsideratë çiftet e reja, pasi janë ato që janë më vulnerabël dhe nuk kanë mundësi drejtpërdrejt për të blerë apartamente, kështu që kemi pasur në shqyrtim këtë prioritet. Nga ana tjetër po me një program tjetër strehimi, nëpërmjet fondit që kemi marrë Ministria e financave do të japim 50% të qerasë për 107 familje, të cilat janë në nevojë, sigurisht që janë të miratuara në bazë të një sistemi pikëzimi.

Nga ana tjetër mjaft e rëndësishme për bashkinë dhe për qytetarët e Durrësit është miratimi i metodologjisë së shorteut për ndarjen e apartamenteve. Dua të theksoj se “Ne” me datë 15 do të bëjmë shortin e parë dhe besoj do të jemi gati për objektet e Manzës, të cilat kanë përfunduar. Kemi lënë një mundësi ku në rastet ku kemi 100% dakortësi të banorëve përfitues për ndarjen e

apartamenteve , do të bëhet kjo dakortësi, që do të shprehet në prezencë të noterit dhe do të bëhet miratimi në Këshill Bashkiak.

Dua të theksoj dhe diçka tjetër, që me fondin që “Ne” kemi futur në këtë mbledhje është një fond që merret nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin dhe “Ne” për procedurë e fusim në Këshill Bashkiak më tepër për të vijuar procedurën e prokurimit. Pallatet të cilat janë miratuar për financim janë :

- 5 objekte DS4 tek rruga Horizonti, pra tek lagja 18,
- kemi objektin tek rruga Mujo Ulqinaku,
- kemi pallatin 6 katësh tek rruga Venezia, në Rajonin 5.
- kemi objektin në Rajonin 2, Isuf Molla,
- kemi objekt pallat rruga Mozaikëve në Rajonin 3,
- si dhe 2 objektet e Shkozetit, të ndërtuara nga firma ER-AR, për të cilat është miratuar fondi
- shtoj këtu dhe 35 njësi individuale, banesa individuale, për të cilat është miratuar fondi.

“Ne” menjëherë do të fillojmë procesin e prokurimit për të përzgjedhur firmat dhe për të filluar punën në terren. Ju faleminderit dhe për mbështetjen dhe suportin e vazhdueshëm.

Ani Dyrmishi: Faleminderit Kryetare! Falenderoj të gjithë pjesmarrësit këshilltarët, administratën, mediat. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.
Ju faleminderit të gjithëve.

Ky procesvebal mbyllet me nr.rendor 13(trembëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Kryetari Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetari Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetare Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI